



## Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT  
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE  
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika e) të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë **29.03.2012**, nxjerr këtë:

### V E N D I M

**I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-4761/11, për z. *Bezad HALILAJ* – Drejtor i Auditimit në Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm, për shkak se është shmangur situata me konflikt interesi në të cilën ndodhej ky zyrtar i lartë publik.**

**II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.**

### A r s y e t i m

**I. Në lidhje me rastin nr. AKK-03-4761/11 të hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në ushtrimin e funksionit publik, për Zyrtarin e lartë, Bezad Halilaj – Drejtor i Auditimit në Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm, janë ndërmarrë veprimet sipas procedurës së paraparë ligjore, të nevojshme për këtë situatë (Ligji Nr.04/L-051, Neni 18, pika 1).**

Pas identifikimit të rastit me dyshimin e bazuar për ekzistimin e konfliktit të interesit, që shfaqej nga ushtrimi i dy funksioneve të papajtueshme, një si Drejtor i Auditimit në Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm, në njëren anë, dhe ushtrimi i funksionit drejtues të biznesit privat, “4 Audit Group” sh.p.k, në anën tjetër, Zyrtarit të lartë i është bërë shkresa e parë njoftuese nga Agjencia Kundër Korrupsionit – AKK, me datën 27.02.2012 (Neni 18, paragrafi 5, Ligji Nr.04/L-051).

Kësaj shkrese Zyrtari i Lartë, i është përgjigjur brenda afatit ligjor dhe në takim me zyrtarët e Agjencisë, ai është njoftuar për veprimet të cilat, ai në cilësinë e personit të Lartë Zyrtar duhet t’i ndërmerr, për të shmangur situatën e papajtueshme gjatë ushtrimit të funksionit publik dhe funksionit drejtues në ndërmarrjen private.

Zyrtari i Lartë, Bezad Halilaj, me datën 14.03.2012 në Agjencinë Kundër Korrupsionit ka sjell informatat mbi biznesin, (“4 Audit Group” sh.p.k.) të ndryshuara në të cilat shihet se zyrtari

Halilaj, nuk ushtron më funksion menaxhuese e as drejtues në ndërrmarrjen e përmendur. Këto të drejta tani, sipas ligjit, janë bartur te personi i tij i besuar.

Kështu, me këto informacione zyrtare mbi biznesin, të lëshuara nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë, që janë sjellë në Agjencinë kundër Korrupsionit me një shkresë përcjellëse dhe kanë numër protokoli DPK/DPKI, 03-1048/2012, kemi konstatuar se është shmangur situata konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, gjithnjë duke u bazuar në Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në ushtrimin e funksionit publik (Nr.04/L-051).

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari kontaktues)

Drejtor i Agjencisë Kundër Korrupsionit

/ Hasan Preteni /

